

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 64, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 të Rregullores për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4790/1 datë 19.11.2024 dhe Konkluzionin nr.02-245/7 datë 22.01.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 2-të mbajtur më 21.01.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës –paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive (SHTR) SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, për shkeljen e kryer të nenit 64, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 4 nëntor 2024, në disa përmbajtje programore janë transmetuar pjesë nga biseda në gjuhë të huaja si (sërbisht, anglisht ose shqip), pa përkthim paraprak në gjuhën maqedone.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4790/1 datë 19.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas përfundimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veproj sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij, llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmer masë – vërejtje publike në rastet kur është kryer cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 64, paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit janë të detyruar të transmetojnë programin në gjuhën maqedone dhe alfabetin kirilik, ndërsa në rastet kur programi është destinuar për bashkësitë joshumicë, dhe në gjuhën dhe alfabetin e bashkësisë.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, me datë 19 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, transmetuar më 4 nëntor 2024, në nivel lokal, nga ku është konstatuar, shkelje e nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se në shërbimin programor të SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP, me datë 4 nëntor 2024, në disa shërbime programore janë transmetuar pjesë të bisedës në gjuhë të huaja, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedone (në pajtim me lejen PA1 nr.08-56 datë 07.09.2023 për transmetim televiziv, që duhet të transmeton program në gjuhën maqedone). Kështu, në kuadër të emisionit „Radius – Rruga e martesës së ngjalës (Svadbëniet pat na jagullata“ deklarata e bashkëbiseduesi nga Shqipëria është transmetuar, burimisht në gjuhën shqipe, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedone. Në fund të emisionit dokumentar „Planeti Tokë (Pllanetata zemja) – Shpellat (Peshteri)“ të BBC, është transmetuar një pjesë integrale për mënyrën se si është inçizuar programi dokumentar, në të cilën fjalimi i rrëfyesit të emisionit dhe deklaratat e anëtarëve të ekipit, janë transmetuar burimisht në gjuhën angleze pa përkthim në gjuhën maqedone. Në kuadër të emisionit „Radius – Dasma e gurtë (Kamena svadba)“, janë transmetuar deklarata të bashkëbiseduesve nga Serbia, burimisht në gjuhën serbe, pa përkthim në gjuhën maqedone. Në ditën e analizës, është transmetuar dhe inçizim nga koncerti i këngëtarit serb Zheljko Joksimović, në të cilin fjalimet e këngëtarit drejtuar publikut ndërmjet këngëve dhe prezantimit të këngëve, janë transmetuar burimisht në gjuhën serbe, pa përkthim në gjuhën maqedone.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4790/1 datë 19.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP me datë 21.11.2024, dërgoj Shkresë ark.nr.10-4790/2 datë 21.11.2024, me të cilin dorëzoj Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4790/1 datë 19.11.2024, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkeresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoj deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt më 25.11.2024, dhe në afatin e parashikuar SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e 2-të mbajtur më 21.01.2025, shqyrtoj lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi që ndaj SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 të Rregullores për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) dhe Konkluzionin nr.02-245/7 datë 22.01.2025, për kostatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 21.01.2025, miratoi Aktvendim, që publikisht paralajmëron SHTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë SHPKNJP dhe detyrohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për fillimin e kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4790/1 datë 19.11.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.